



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 32, datë 03.02.2023

**PËR**

**MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE SUKTH, RRUGA "YLBERI", PALLATI NR. 24, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019**

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të proçesit të rindërtimit”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 202, datë 05.03.2020 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rindërtimit të banesave individuale”; Vendimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit nr.104, datë 08.07.2022; Urdhërit nr.164, datë 01.07.2020 “Për ngritjen e komisionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit”, i ndryshuar, të raportit të Komisionit të Posaçëm miratuar nga titullari i institucionit me nr. nr. 1169/1 prot., datë 30.01.2023 si dhe sipas relacionit të hartuar nga ky komision, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative Sukth, rruga “Ylberi”, pallati nr.24, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, sipas Aneksit nr.1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Subjektet përfituese të pallatit nr. 24, në Njësinë Administrative Sukth, rruga “Ylberi” do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit të Zonës së Re për Zhvillim nr. 4, Njësia Administrative Durrës, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 164, datë 19.2.2020, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, në Njësinë Administrative Durrës, Bashkia Durrës, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese”, i ndryshuar.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 07.02.2023**

**ANEKSI 1. SUBJEKTET PËRFITUESE TË PALLATIT NR.24, RRUGA "YLBERI"**

<b>Nr.</b>	<b>PRONARI</b>	<b>GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES</b>	<b>STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHET</b>
1	NEVRUZ AGOLLI, MAJLINDA AGOLLI	2	1+1
2	SHKELQIM KAJA	4	2+1
3	SHPETIM KAJA	3	2+1





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS


Nr. 108/9 prot.

Durrës, më 14.02 .2023

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.32 datë 03.02.2023 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në njësinë administrative Sukth, rruga "Ylberi", pallati nr. 24, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

